



Lugina e Lumit Vjosa – studimi për mbrojtjen në bazë të standardeve të IUCN-së për zonat e mbrojtura

PËRMBLEDHJE

Studimi “Lugina e Lumit Vjosa- studimi për mbrojtjen në bazë të standardeve të IUCN-së për zonat e mbrojtura” është përgatitur nga Dr. Andrej Sovinc, Zëvendës- Kryetari Rajonal për Europën i Komisionit Botëror të IUCN-së për Zonat e Mbrojtura (WCPA) [KBZM], në kuadër të projektit “[Shpëtimi i lumit të fundit të egër me rrjedhë të lirë në Europë – Vjosa/Aoos](#)”. Qëllimi i tij është t’i shërbejë autoriteteve kombëtare në Shqipëri dhe të kontribojë ndaj procesit të mbrojtjes së luginës së Lumit Vjosa, i bashkërenduar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në Shqipëri dhe Agjencia Kombëtare për Zonat e Mbrojtura (AKZM). Gjetjet e studimit bazohen si në karakteristikat fizike ashtu edhe ato ekologjike të zonës, si dhe objektivat e menaxhimit dhe regjimet e duhura të mbrojtjes që vijnë nga sistemi shqiptar i kategorive të zonave të mbrojtura, për të siguruar mbrojtje afatgjatë të karakterit ekologjik dhe biodiversitetit të luginës së Lumit Vjosa.

Lugina e Lumit Vjosa është renditur në draft-versionin e dokumentit "Vendimi për Miratimin e Kufijve të Zonës së Mbrojtur" si një Rezervë e Menaxhuar Natyrore/Park Natyror i propozuar i ardhshëm (ekuivalent me kategorinë IV të IUCN-së për ZM-të) nga kufiri grek deri në Detin Adriatik; zona e propozuar e mbrojtur përfshin vetëm lumin kryesor, pa degët e tij. EcoAlbania ka paraqitur një propozim për të krijuar një park kombëtar (ekuivalent me kategorinë II të IUCN-së për ZM-të) i cili mbulon të gjithë Lumin Vjosa së bashku me të gjitha degët e tij.

© Gernot Kunz



Prezantimi i Lumit Aoos-Vjosa

Lumi Aoos-Vjosa ka një shtrirje prej 272 km duke filluar që nga burimi i tij në Greqi, duke përshkruar Shqipërinë e Jugut, e duke u derdhur në Detin Adriatik. 80 km e para i përkasin Greqisë. Sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës është 6,704 km², nga të cilat 4,365 km² ndodhen në territorin shqiptar.

Vjosa dhe degët e saj mund të klasifikohen si një nga lumenjtë gëlqerorë, me kthesa e gjarpërime anësore aktive, me degëzime të pandërprera, me prurje të mëdha depozitimesh, ku prurjet e mbathjes së tabanit janë më të mëdha se niveli i prurjeve të kanalit, të cilat pasqyrohen veçanërisht në rrjedhën e mesme të lumit, në pllaja me përqëndrim të lartë zhavorri deri në 2,000 m të gjera, të përshkuara nga degëzime të shumta anësore dhe paralele, pellgje liqenore harkore dhe degëzime në formë kanalesh anësore. Një tjetër kriter i ngritjeve apo kufizuesve gëlqerore në degëzimet anësore e të pandërprera janë format e veçanta të ndërprerjes së rrjedhës së rrëmbyeshme, të cilat pasqyrohet në braktisjen e menjëhershme të kanalit të lumit kryesor kryesisht gjatë ngjarjeve ekstreme të përmytjeve dhe formimit të kanaleve të reja paralele me lumin në formën e ultësirave me prirje për t'u përmytur.

Kërkimet dhe studimet e kryera në tarracën e mesme të Lumit Vjosa, vitet e fundit kanë nxjerrë në pah praninë dhe dendësinë e madhe të llojeve si dhe shumëllojshmërinë e habitateve të rrezikuara në nivelin Europian. Gjithashtu është konfirmuar prania e llojeve të shumta të rrezikuara në mënyrë kritike në rang botëror dhe kombëtar. Tipar i veçantë është prania e llojeve të ndryshme të habitateve të ruajtura mjaft mirë por të kërcënuara sipas nivelit të BE-së, të cilat gjenden përgjatë tarracës së mesme të Lumit Vjosa dhe degëve të tij.

Në tarracën e mesme të Lumit Vjosa gjenden të paktën 8 lloje habitatesh me rëndësi të madhe të ruajtjes sipas nivelit të BE-së. Në këtë zonë gjenden jo më pak se 1,175 lloje nga të gjitha grupet taksonomike, duke përfshirë 13 lloje kafshësh të kërcënuara globalisht dhe 2 lloje bimësh vaskulare. Po ashtu, gjenden të paktën 148 lloje të interesit Europian të listuara në Konventën e Bernës, 41 lloje shpendësh dhe 78 lloje kafshësh dhe bimësh të listuara në Listën e Shpendëve të BE-së dhe Direktivat për Habitatet. Në Listat e Kuqe kombëtare të Shqipërisë janë përfshirë të paktën 50 lloje kafshësh dhe 24 bimë vaskulare

Është përcaktuar rëndësia e të gjithë korridorit të lumit për llojet migratore (p.sh. llojet e ngjalave të rrezikuara) dhe zonave ku shfaqen përqendrime të mëdha të organizmave për shumim dhe/ose mbarësim.

Përcaktimi i kategorisë së zonës së mbrojtur nga IUCN-ja

Vlerësimi i kategorisë dhe statusit të mundshëm të zonës së mbrojtur u ndërmor në luginën e Lumit Vjosa në përputhje me standardet ndërkombëtare për zonat e mbrojtura i kryer nga Unioni Ndërkombëtar për Mbrojtjen e Natyrës (IUCN-ja). Qëllimi i vlerësimit ishte të identifikoheshin mënyrat më të mira për mbrojtjen e efektshme të luginës së Lumit Vjosa, dhe për të propozuar një model për zhvillimin e zonës.

Kategoritë e zonave të mbrojtura të IUCN-së përcaktohen në seksionin e përshkrimit fizik dhe ekologjik dhe objektivat përkatëse për zonën. Lugina e Lumit Vjosa përkon me përkufizimin e IUCN-së për një

zonë të mbrojtur. Vlerësimi i kushteve fizike dhe ekologjike tregon se tarraca e sipërme e Lumit Vjosa dhe degët e tij përbëjnë një ekosistem me lloje kryesisht autoktone, të karakterizuara nga procese natyrore. Në tarracën e mesme, funksioni i pandërprerë i ekosistemit përqendrohet në shtratin e ngushtë të lumit, gjerësia e të cilit nuk lejon ndikimin drastik të ndërhyrjeve të jashtme nga sektori i bujqësisë apo veprimtaritë e tjera të njerëzve. Vlera e ruajtjes së tarracës së mesme të Lumit Vjosa ka qënë vazhdimisht në vëmendjen e kërkimeve të shumta të kryera vitet e fundit, ku demonstrohet se ky është lumi i fundit me degë të pandërprera e i pandryshueshëm i këtij lloji në Ballkan dhe në mbarë Europën. Tarraca e poshtme e Lumit Vjosa, në rrjedhën e poshtme të bashkimit me Shushicën, ruan gjithashtu karakteristikat e lumit natyror: rrjedha e ujit dhe prurjet e depozitimeve janë mjaft të rëndësishme për stabilizimin e zonës bregdetare. Çdo ndryshim i këtyre parametrave përgjatë të gjithë shtrirjes së lumit do të shkaktonte ndikime të mëdha në karakterin ekologjik të rrjedhës së poshtme dhe asaj të sipërme të lumit.

Laguna e njelmët e Nartës ka një vlerë të rëndësishme për ruajtjen në shkallë kombëtare dhe globale dhe duhet të jetë pjesë e zonës së mbrojtur të luginës së Lumit Vjosa; rëndësia globale e ruajtjes së kësaj lagune të njelmët është mjaft e nënvlerësuar.

Biodiversiteti i rëndësishëm vendas i nivelit kombëtar, rajonal dhe global dhe vlerat e jashtëzakonshme panoramike të luginës së Lumit Vjosa janë rezultati i hidromorfologjisë së pacënuar të lumit dhe proceseve të plota të funksionimit, të cilat duhet të mbrohen përgjatë të gjithë shtrirjes së Lumit Vjosa dhe degëve të tij kryesore: Çdo ndryshim në rrjedhën e ujit dhe prurjeve të depozitimeve do të ndryshonte jashtë mase ekosistemin e lumit të fundit të këtij lloji në Ballkan dhe në mbarë Europën dhe do të mbyllte korridorin e migrimit të llojeve të peshqve të kërcënuar globalisht.

Mbrojtja e dukurive dhe veçorive ekzistuese natyrore, së bashku me trashëgiminë e pasur kulturore, duhet të bazohen në krijimin e zonës së mbrojtur, me nënzonën kryesore të mbrojtjes të përqendruar përgjatë shtratit të ngushtë të lumit (i cili zgjerohet vetëm në tarracën e mesme të Lumit Vjosë) dhe degëve të tij, si dhe lagunës së njelmët bregdetare të Nartës.

Mbrojtja e shtratit të ngushtë të lumit duhet të sigurohet përgjatë gjithë rrjedhës së lumit në mënyrë që të arrihet mbrojtja bazë e " vazhdimësisë" së lumit dhe prurjeve të depozitimeve, meqenëse çdo ndërhyrje e mundshme përgjatë shtratit të lumit mund të ketë ndikime në rrjedhën e sipërme dhe të poshtme. Duhet të vërehet se mbrojtja strikte e shtratit të ngushtë të lumit mbulon vetëm zonat të cilat nuk përdoren apo nuk shfrytëzohen kryesisht nga njerëzit.



Tre modele të propozuara për zonën e mbrojtur për lumin Vjosa dhe degët e tij

(1) PARKU KOMBËTAR (tarraca e sipërme dhe e mesme) dhe PEIZAZHI I MBROJTUR (tarraca e poshtme)

Ky model do të ishte i efektshëm qoftë për sigurimin e mbrojtjes së duhur të ekosistemeve natyrore dhe biodiversitetit autokton, ashtu edhe në lidhje me zhvillimin e modelit të ri të zhvillimit për zonën e Vjosës, në bazë të turizmit të gjelbër dhe atij kulturor. Në bazë të këtij modeli, zona kryesore (Zona 1) e Parkut Kombëtar duhet të krijohet së bashku me tarracat e sipërme dhe të mesme të shtratit të ngushtë të Lumit Vjosa dhe degëve të tij. Tarraca e poshtme e Lumit Vjosa dhe Laguna e Nartës duhet të jenë pjesë e Parkut të Peizazhit ku duhet të krijohet zonimi i duhur. Zonimi së bashku me zonën kryesore duhet të ruajnë veprimtaritë tradicionale të banorëve të zonës.

(2) PARKU KOMBËTAR me zonim të ndryshëm për tarracën e poshtme të Lumit Vjosa

Ky model do të përfshinte të gjithë shtratin e ngushtë të Lumit Vjosa dhe degëve të tij në Parkun Kombëtar, por sipas koncepteve të ndryshme të zonimit: tarracat e mesme dhe të sipërme janë pjesë e nënzonës kryesore (Zonës 1) të Parkut Kombëtar, ndërsa tarraca e poshtme është në nënzonën e Parkut Kombëtar (Zonën 2 – me krijimin e mundshëm të nënzonës së Përdorimit Tradicional dhe Të Qëndrueshëm dhe nënzonës së Shlodhjes). Laguna e Nartës supozohet gjithashtu të jetë pjesë e Parkut Kombëtar (Zonës 2, si nënzona e Shlodhjes). Në këto nënzona, duhet të ruhen veprimtaritë tradicionale të banorëve të zonës.

(3) MONUMENTI I NATYRËS (tarraca e sipërme) dhe PARKU KOMBËTAR (tarraca e mesme) dhe PARKU KOMBËTAR ose PEIZAZHI I MBROJTUR (tarraca e poshtme)

Ky model është i njëjtë me modelet e mëparshme, por lejon të merret parasysh krijimi i Monumentit të Natyrës në tarracën e sipërme të luginës së Lumit Vjosa.

Zona e propozuar për mbrojtje është e madhe, veçanërisht përgjatë profilit të shtrirjes gjatësore, kështu që duhet të merret në konsideratë një qasje me faza, me statusin e mbrojtjes të arritur për tarracat e Lumit Vjosa dhe degëve të tij, dhe së pari mbrojtjen e siguruar për tarracat më të vlefshme.

Modelet e mbrojtjes të renditura më lart do të lejonin zhvillimin e turizmit të gjelbër dhe format e qëndrueshme të bujqësisë dhe kullotave në zonat dytësore dhe buferike të zonës së mbrojtur.